

VENDIM
Nr. 657, datë 3.11.2021

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 618, DATË 20.10.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN E FUNKSIONIMIN E
RRJETIT TË KOORDINATORËVE KUNDËR KORRUPSIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun IV, të vendimit nr. 618, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 15, shtohet pika 16, me këtë përmbajtje:

“16. Përveç pagës mujore, nëpunësit në strukturën përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë përfitojnë një shtesë për natyrë të veçantë pune, në masën:

a) 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në muaj, në pozicionet “drejtor i përgjithshëm”, si dhe “drejtor drejtorie”, “përgjegjës sektori” e “specialist”, në drejtorinë që mbulon Rrjetin e Koordinatorëve Kundër Korrupsionit;

b) 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, në pozicionet “drejtor drejtorie” dhe “specialist”, në drejtorinë që mbulon njësinë operacionale të verifikimit në terren;

c) 40 000 (dyzet mijë) lekë në muaj, në pozicionet “drejtor drejtorie”, “përgjegjës sektori” dhe “specialist”, në drejtorinë që mbulon projektet e programet në fushën kundër korrupsionit.”.

2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama